



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



Nr. Serial 000005

**AUTORIZIM
PËR VEPRIMTARI NDËRTIMORE NË BRIGJE**

Nr. 368 Prot., datë 26/09/2022

Miraturar me:

VENDIM TË KËSHILLIT TË BASENIT UJOR DRIN-BUNË

Nr. 27 , datë 22/09/2022

Emri i individit/subjektit:	BASHKIA POGRADEC
I regjistruar si subjekt me këto të dhëna (NID/ NIPT):	K44802605R
Baseni Ujor:	DRIN-BUNË
Qarku:	KORÇË
Bashkia/ Njësia administrative:	POGRADEC/BUÇIMAS
Koordinatat:	X ₁ =560031; Y ₁ =4529373; Z ₁ =693.33 X ₂ =560013; Y ₂ =4529010; Z ₂ =693.3 X ₃ =560077; Y ₃ =4529018; Z ₃ =693.35 X ₄ =560047; Y ₄ =4528796; Z ₄ =693.3 X ₅ =560088; Y ₅ =4528575; Z ₅ =693.4
Lloji i burimit ujqor ku do të kryhet veprimtaria:	Parku ujqor Tushemisht - Drilon
Lloji i veprimtarisë që do të kryhet:	Veprimtari ndërtimore në brigje
Kufizime në ushtrimin e veprimtarisë (nëse ka):	Sipas Kushteve të lejes.
Periudha e vlefshmërisë:	2 Vjet (nga data e miratimit deri në fillimin e zbatimit në terren)
Hyrja në fuqi	Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektit

KRYETARI

MAJLINDA ANGONI



Kushtet e posaçme të lejes për veprimtari ndërtimore në brigje

1. Të përdorë ujërat në mënyrë racionale, duke shmangur mbetjet dhe duke mos dëmtuar mjedisin;
2. Të përdorë ujërat vetëm për qëllimet, për të cilat i është dhënë autorizimi;
3. Të paguajë të gjitha kostot, taksat, tarifat në lidhje me përdorimin e ujit;
4. Të instalojë, ose të lejojë instalimin e pajisjeve për matjen e sasisë së ujit të përdorur, në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga organet e menaxhimit të burimeve ujore;
5. Të japë të dhëna dhe informacion për përdorimin e ujit sa herë që i kërkohet nga organet e ngarkuara për menaxhimin e burimeve ujore;
6. Autorizimi nuk mund t'i transferohet një subjekti tjetër pa miratimin e organeve të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore;
7. Të respektojë kushtet higjieno-sanitare dhe të mbrotjes së mjedisit
8. Të mos dëmtojë brigjet dhe shtratin e burimit ujqor;
9. Të mos ndryshojë rrjedhjen natyrore të burimit ujqor;
10. Të bashkëpunojë dhe të mos pengojë kryerjen e kontrolleve nga autoritetet përkatëse të ujit;
11. Të lejojë rrjedhjen ekologjike të miratuar;
12. Të sigurojë marrjen e menjëhershme të masave dhe veprimeve për të minimizuar, ose parandaluar ndonjë ndikim në mjedisin ujqor, ose në brigje në rast të një aksidenti, apo incidenti;
13. Të kompensojë dëmin e shkaktuar dhe të rikthejë mjedisin ujqor në gjëndjen e mëparshme;
14. Të mos çënojë faunën dhe florën ujore e tokësore dhe të marrë masa për mbrotjen e specieve të rralla;
15. Të sigurojë, nga pikëpamja sasiore dhe cilësore, kushte për të mundësuar përdorimin e burimit ujqor nga subjekte të tjerë;
16. Të zbatojë parimet dhe kushtet të tjera për veprimtarinë të përcaktuara në ligjin për menaxhimin e burimeve ujore.